

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Venhar Salihu, me bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, në çështjen kontestimore të paditëses _____ nga _____, lagja _____, rruga _____, nr. _____, ndaj të paditurës Komuna e Gjilanit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson i autorizuari i saj ligjor _____ nga _____, me objekt kontesti, pagesa e shpërblimit jubilar dhe pagat përcjellëse me rastin e pensionimit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, më datë 11.05.2018. mori këtë:

AKTGJYKIM

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses _____ nga Gjilani dhe **OBLIGOHET** e paditura Komuna e Gjilanit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, që paditëses _____ nga Gjilani t'ia paguajë tri (3) paga mujore për përcjellje në pension në shumën prej 1.470 €, si dhe dy paga mujore në vlerë prej 980 € në emër të pagave jubilarë, e të gjitha në vlerë të tërësishme prej 2.450€, me kamatë ligjore prej 3.5%, duke llogaritur nga data 22.06.2017, si datë e paraqitjes së padisë në gjykatë, e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditësh nga marrja e këtij aktgjykimi, nën kërcënim e ekzekutimit të dhunshëm.

II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë lidhur me një (1) pagë jubilarë në vlerë prej 490 € e kërkuar më tepër se shuma e gjykuar.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore.

A r s y e t i m i

Paditësja _____ nga Gjilani më datë, 22.06.2017, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjilanit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, me të cilën ka kërkuar që të miratohet kërkesëpadia e saj dhe të obligohet e paditura që paditëses t'ia bëjë pagesën e tri pagave në emër të shpërblimit jubilar si dhe pagesën e tri pagave përcjellëse për pensionim në shumë të tërësishme prej 2.026,00 € me kamatë ligjore prej 3,5 %, duke llogaritur nga data 22.06.2017, si datë e paraqitjes së padisë në gjykatë, e deri në pagesën përfundimtare, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm, meqenëse një e drejtë e tillë bazohet në Dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit Para Universitar, përkatësisht në nenin 36 par.9. nënpar.9.3 (shpërblimi jubilar) dhe paragrafi 10 (pagesa përcjellëse në lartësi të tri pagave). E njëjta kërkesëpadinë e saj e ka ndryshuar në shqyrtimin gjyqësor të dt. 20.04.2018, ashtu që ka kërkuar që në vend të shumës së tërësishme prej 2.026,00 €, tani kërkon pagesën e tri pagave jubilarë në shumë prej 1.470,00 €, si dhe pagesën e tri pagave përcjellëse për pensionim në shumë prej 1.470,00 € në total në shumë prej 2.940,00 €, me kamatë ligjore prej 3.5 %, nga dita e paraqitjes së paditë e deri në pagesën përfundimtare.¹

Kjo gjykatë ka caktuar seancë për dt. 05.04.2018, në të cilën seancë ia ka dorëzuar të paditurës padinë e paditëses, në mënyrë që e njëjta të përgjigjet lidhur me pretendimet e paditëses.

¹ Gjykata me aktvendimin C.nr.464/17 të dt.18.08.2017 e ka pezulluar procedurën për 180 ditë.

E paditura në përgjigje në padi e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses për arsye se paditësja kërkesëpadinë e saj e bazon në Kontratën e Përgjithshme Kolektive të Kosovës e miratuar dhe nënshkruar nga BSKP, Qeveria e Kosovës (Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale) dhe Oda Ekonomike e Kosovës, respektivisht nenin 42, 43 dhe 44 të kësaj kontrate, gjersa konsiderojnë se kjo kontratë nuk prodhon efekte juridike dhe nuk krijon të drejta dhe detyrime ndaj Komunës së Gjilanit si e paditur në këtë rast dhe e njëjta kontratë nuk është në fuqi.

Paditësja për realizimin e të drejtës së saj të pretenduar fillimisht i është drejtuar Drejtorisë së Arsimit në Gjilan më datë 07.06.2017 me kërkesë për pagesën e tri pagave për përcjellje në pension dhe kompensimin e tri pagave mujore për shpërblim jubilar, e që më datë 21.06.2017 është njoftuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit se kërkesa e saj është e paralizueshme meqenëse Ekzekutimin e pagave e bënë Ministria e Financave, gjegjësisht Divizioni i pagave në kuadër të kësaj Ministrie dhe për shkak se ende nuk është duke u zbatuar kontrata kolektive për sa i përket këtyre pagave, kjo Ministri nuk po i ekzekuton asnjë pagesë e në këtë rast pagesat pas pensionimit.

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësja si në shqyrtimin përgatitor, kryesor ashtu edhe në shpjegimet përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë, kërkesëpadisë dhe precizimit e saj të paraqitur në këtë gjykatë, duke kërkuar nga gjykata që të njëjtën ta aprovojë si të bazuar, ashtu që ta obligoj të paditurën Komuna e Gjilanit t'ia paguaj tri paga mujore në shumën e tërësishme prej 1.470,00 € për shpërblim jubilar, të 3 pagesave mujore për përcjellje në pension shumën prej 1.470,00 € e që kapin shumën e përgjithshme prej 2.940,00 €, të gjitha këto me kamatë prej 3.5% nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare.

Përfaqësuesi i të paditurës, Komuna e Gjilanit - Drejtoria Komunale e Arsimit, si në shqyrtimin përgatitor, kryesor ashtu edhe në shpjegimet përfundimtare ka deklaruar se mbetet pranë përgjigjes në padi të dt. 24.04.2018, duke kërkuar nga gjykata që të njëjtën ta refuzojë në tërësi si të pabazuar, duke shtuar se Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar e dt. 18.04.2017 nuk prodhon asnjë efekt juridik në raport me komunën e Gjilanit për faktin se komuna nuk është nënshkruese e këtij dokumenti dhe është autoritet i pavarur publik, ndërsa asnjë ligj në fuqi që rregullon çështjen e pensioneve nuk e obligon Komunën e Gjilanit që të bëjë kompensimin sa i përket kësaj natyre.

Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Gjykata për të vepruar drejt dhe për t'i vërtetuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse si dhe për të vërtetuar drejt gjendjen faktike në këtë çështje kontesitmore ka administruar dhe vlerësuar këto prova: Aktvendimi 05.nr.43839, i lëshuar nga Komuna e Gjilanit, me dt.02.05.2017 për ndërprerjen e punës së paditëses nga e paditura; Kërkesa me nr. 05-610/01-0056396/17 e dt.07.06.2017 me të cilën kërkesë paditësja ka kërkuar nga e paditura kompensimin me rastin e pensionimit; Përgjigja e dt. 21.06.2017 e dhënë nga e paditura; Transaksioni – pasqyra bankare e dt. 21.06.2017, e lëshuar nga Bank; Lista e pagave e lëshuar nga Buxheti i RKS-së; Vërtetimi i dt. 07.05.2018 i lëshuar nga SBASHK-u.

Vlerësimet juridike dhe faktike të gjykatës

Pas vlerësimit me kujdes të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku si në kuptim të nenit 8 të LPK si dhe në bazë të rezultatit të gjithmbarshëm të procedurës kontestimore, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

Se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Gjiilan në Gjimnazin “ ” në Gjiilan, në pozitën mësimdhënëse e rregullt në lëndën e sociologjisë, profesion të cilin e ka ushtruar për njëzet vite dhe e njëjta për tre muajt e fundit ka realizuar të ardhura mujore në vlerë neto prej 490.13 €, fakte këto të vërtetuar nga pasqyra e llogarisë bankare në emër të paditëses e lëshuar nga për periudhën kohore prej 01.03.2017 deri më 26.06.2017 dhe nga lista e pagave e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës e muajit shkurt të vitit 2017

Të njëjtës sipas fuqisë ligjore – Aktvendimit, i ka përfunduar marrëdhënia e punës, pasi që ka mbushur moshën 65 vjeçare, e cila u vërtetua nga Vendimi i Drejtorisë së Arsimit-Komuna e Gjiilanit me nr. 05.nr.43839 të me dt.02.05.2017.

Nga kërkesa me nr. e dt.07.06.2017, gjykata vërtetoi faktin se paditësja fillimisht i është drejtuar organit kompetent që t'i njihet e drejta lidhur me lartësinë e pagave mujore pas pensionimit.

Nga përgjigja e dt. 21.06.2017 e dhënë nga e paditura, gjykata vërtetoi faktin se e paditura ka shqyrtuar kërkesën e paditëses mirëpo në të njëjtën është përgjigjur se ekzekutimin e këtyre pagave e bën Ministria e Financave gjegjësisht Divizioni i pagave.

Nga vërtetimi i lëshuar nga SBASHK-u i dt. 07.05.2018 gjykata, vërtetoi faktin se paditësja ka qenë anëtare e SBASHK-ut deri në daljen në pension.

Dispozitat ligjore të zbatuara me rastin e marrjes së vendimit

Gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtës subjektive të paditëses, bazës juridike të padisë dhe lartësisë së saj, ka zbatuar dispozitat e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, konkretisht nenin 52 par. 1, nënpar. 2 dhe nenin 53, e gjithashtu edhe Kontratën Kolektive të Arsimit Para Universitar, përkatësisht nenin 36, par.9, nënpar. 2, si dhe paragrafin 10 të të njëjtit nen, ndërsa procedura është zhvilluar në bazë të Ligjit të Procedurës Kontestimore në fuqi.

Gjykata vendosi si në pikën I (të dispozitivit të këtij aktgjykimi) që ta aprovojë pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe e detyroi të paditurën Komunën e Gjiilanit-Drejtorin e Arsimit në Gjiilan që t'i paguaj të paditurës tri (3) paga mujore për përcjellje në pension në shumën prej 1.470 €, si dhe dy paga mujore në vlerë prej 980 € në emër të pagave jubilarë, e të gjitha në vlerë të tërësishme prej 2.450€, me kamatë ligjore prej 3.5%, duke llogaritur nga data 22.06.2017, si datë e paraqitjes së padisë në gjykatë, e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditësh nga marrja e këtij aktgjykimi, nën kërcënim e ekzekutimit të dhunshëm tre (3) paga mujore.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi që ta refuzojë si të pabazuar kërkesë padinë e paditësit lidhur me një (1) pagë jubilarë në vlerë prej 490 € e kërkuar më tepër se shuma e gjykuar.

Gjykata ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi që secila pale ti bartë shpenzimet e procedurës kontestimore konform nenit 450 të LPK-së.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e përfaqësuesit të të paditurës se Komuna e Gjilanit nuk është nënshkruese drejtpërdrejtë e ndonjë marrëveshje kolektive, mirëpo nënshkruese e kontratës kolektive për Arsimin Para Universitar është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, e cila është në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku në nenin 2 paragrafin 1.1 dhe 1.2 Kontratë Kolektive të Arsimit Para Universitar parashihet “1.1 Dispozitat e kësaj kontrate kolektive janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë) në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut.”, “1.2 Dispozitat e kësaj kontrate kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit, DKA-të dhe MASHT në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës” e në rastin konkret e njëjta ka qenë në marrëdhënie pune pranë Komunës së Gjilanit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan –DKA, si dhe anëtare e SBASHK-ut.

Nga arsyet e cekura më lart e bazuar edhe në nenin 143 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C.nr.464/17, dt. 11.05.2018

Gjyqtari
Venhar Salihu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditë, pas ditës së pranimi të vendimit. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftueshme përmes kësaj gjykate.

